Shkurt 2026, nr. 2

Gazeta e Rahovecit

Kosova, 18 vjet shtet

Për 18-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, dita në Komunën e Rahovecit nisi me pritjen tradicionale të qytetarëve dhe më pas me nderimin e atyre që sakrifikuan jetën për lirinë dhe për pavarësinë e Kosovës.

Më pas, u mbajt seancë solemne për të nderuar e për të kujtuar të veprimtarët e çështjes kombëtare, dëshmorët e heronjtë që luftuan e ranë për jetësimin e lirisë e të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Kërkohet respekt rigoroz për orarin e punës nga shërbimi farmaceutik

Në një takim me pronarët e barnatoreve private që operojnë në Rahovec, Kryetari Latifi kërkoi nga ta që, me qëllim që shërbimi farmaceutik të jetë i garantuar në çdo kohë për qytetarët, të respektojnë orarin e tyre të punës, përfshirë edhe të dielave e festave zyrtare.